



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 401/2 Prot.

Tiranë, më 18/04/2023

VENDIM

Nr. 22, DATË 18/04/2023

MBI

**“FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E KANDIDATURAVE PËR NGRITJEN  
E KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË STANDARDEVE TË CILËSISË NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i) dhe 1(j), në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pika 3(b) dhe nenin 35 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pika 2(b) dhe neni 25 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pikat 1(b) dhe 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidatave për anëtarë në Komisionin e Sigurimit të Standardeve të Cilësisë në Universitetin e Arteve.
2. Komisioni përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët nga 1 (një) përfaqësues prej secilit Fakultet të UART, 1 (një) përfaqësues specialisti i NJSBC-së pranë UART dhe 1 (një) përfaqësues nga studentët. Përfaqësuesit e fakulteteve në këtë komision duhet të jenë personel akademik me kohë të plotë të ngarkuar nga Dekanati për sigurimin e brendshëm të cilësisë në fakultetet përkatëse.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni 35, pikat 2 dhe 3 të Statutit të UART:
  - Për anëtarët, pjesë e personelit akademik:
    - a. Të kenë minimalisht gradën shkencore “Doktor”;
    - b. Të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare;
    - c. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Anëtari përfaqësues i studentëve, duhet të jetë student me mesatare të përgjithshme mbi 9.
4. Anëtarët e Komisionit zgjidhen për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
  5. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A dhe afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 26.04.2023.
  6. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI

Prof. Asoc. Genc FUGA

Erlind FUSHA (Student FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT, P/A

### KËRKESË PËR KANDIDIM

#### PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË STANDARDEVE TË CILËSISË (STAF AKADEMIK)

Unë, i/e nënshkruar/i/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, të rrethit \_\_\_\_\_, gjinia \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në zgjedhjet e muajit prill 2023, si përfaqësues i Fakultetit \_\_\_\_\_.

Në përputhje me Statutin e Universitetit të Arteve, miratuar me vendim të Senatit Akademik Nr. 15, datë 30.08.2021, nën përgjegjësinë time personale, deklaroj se:

- Jam pjesë e personelit akademik me kohë të plotë i ngarkuar nga Dekanati për sigurimin e brendshëm të cilësisë në fakultetin përkatës;
- Kam minimalisht gradën shkencore “Doktor”;
- Kam përvojë pune si anëtar i personelit akademik për një periudhë së paku pesëvjeçare;
- Ndaj meje nuk ka një masë disiplinore në fuqi.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- Kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kopja e noterizuar e gradës/titullit që unë zotëroj;
- Vërtetimi i qendrës time të punës;
- Vërtetimi që nuk kam marrë masë disiplinore.

**Autorizim:** Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.

**Shënim:** Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij formulari do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

**Aplikuesi**

\_\_\_\_\_  
Emër, Mbiemër, Firmë

U dorëzua më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, pranë Zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE INFORMACIONIT, P/A

## KËRKESË PËR KANDIDIM

### PËR ANËTAR TË KOMISIONIT TË SIGURIMIT TË STANDARDEVE TË CILËSISË

(STUDENTË)

Unë, i/e nënshkruar/i/a \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, në \_\_\_\_\_, të rrethit \_\_\_\_\_, gjinia \_\_\_\_\_, student/e në programin e studimit \_\_\_\_\_, të Fakultetit \_\_\_\_\_, paraqes kërkesën time për të kandiduar për anëtar të Komisionit të Sigurimit të Standardeve të Cilësisë, në zgjedhjet e muajit prill 2023, si përfaqësues i Studentëve në këtë Komision.

Kësaj kërkesë i bashkëngjitet:

- Kopja e kartës së identitetit/pasaportës;
- Vërtetimi që jam student (viti i I-II bachelor dhe viti i I – II master);
- Lista e notave që dëshmon mesataren e përgjithshme të notave mbi 9 (nëntë) deri në momentin e kandidimit;
- Vërtetimi që nuk kam marrë masë disiplinore.

***Autorizim:** Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre.*

***Shënim:** Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij formulari do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.*

**Aplikuesi**

\_\_\_\_\_  
*Emër, Mbiemër, Firmë*

U dorëzua më datë \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_\_\_, pranë Zyrës së Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/P-A.

